



Avioni i së ardhmes do të marrë hua nga zogjtë strukturën e skeletit të tyre, për të përforcuar pjesën ku vendoset motori dhe për të eliminuar dritaret, me qëllim që avioni të jetë i pajisur me vetrata panoramike. Kjo do të arrihet edhe përmes faktit se klasët e fluturimit do të eliminohen, pak a shumë.

Në vend të klasit “bussines” dhe “turist” do të vendosen zona me opsione të ndryshme, që nga ato që ofrojnë shërbime estetike deri tek ato me shërbime ultra-teknologjike, në mënyrë që udhëtimi të kthehet nga një humbje kohe në një mundësi për të shijuar kohën e lirë.

Të paktën ky është vizioni i Airbus, që dje në Londër ka paraqitur para shtypit planin e tij “Concept Cabin” për vitin 2050.

Plani është një projekt edhe më ambicioz, të imagjinosh jo vetëm avionin e së ardhmes, por edhe një treg të ri referimi.

Ky i fundit, me sa duket, përveçse synon spostimin në një ambient më të rehatshëm, kërkon konsume më të ulëta dhe më shumë respekt për ambjentin./tch/

cAGT5A589xE